

# Monitorimi i Mbledhjeve të KGJK-së për periudhën Prill-Qershor 2023

Gjatë periudhës prill-qershor Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur gjithsej 5 takime. Dy në muajin prill, një në muajin maj, dhe dy takime në muajin qershor.



Prej 5 agjendave të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, 3 nga agjendat janë publikuar në kohën e paraparë me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, konkretisht me nenin 14 paragrafi 2 ku kërkohet që "Rendi i ditës së Këshillit do të jetë publikisht i hapur së paku dyzet e tetë (48) orë para takimit." Ndërsa 2 agjenda të tjera nuk janë publikuar me kohë ashtu siç e parashikon edhe legjislacioni në fuqi.



Nga 5 takimet e mbajtura, të gjitha agjendat janë publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.



Pjesëmarrja e anëtarëve të KGJK-së, për çdo takim, e paraqitur në grafikon.

Të pranishëm Munguan

6 Prill 20 Prill




18 Maj 12 Qershor 20 Qershor



Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, 12 pika të rendeve të ditës të mbledhjeve të mbajtura kanë qenë të mbyllura për publikun.



KGJK në mbledhjet saj ka marrë disa vendime dhe se të njëjtat janë publikuar në ueb-faqen e KGJK.



Vonesa mesatare e fillimit të takimeve të këshillit gjatë kësaj periudhe ka qenë 15 minuta. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur për secilen mbledhje se sa është vonuar fillimi i takimeve.



Anëtarët më aktiv gjatë mbledhjeve të KGJK-së për këtë periudhë tre-mujore, të cilët kanë dhënë më së shumti kontribut në diskutimet e zhvilluara në këto takime, janë:

